

KosovaLive, 18 shkurt 2005

Intervistë me ambasadorin e OSBE-së në Shqipëri Pavel Vacek

Zhvillimi i zgjedhjeve demokratike në Shqipëri përbën kontribut edhe për rajonin

Elona Daka

Tiranë (KosovaLive) - Ambasadori i Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Pavël Vacek, në një intervistë dhënë për KosovaLive, thotë se zhvillimi i zgjedhjeve parlamentare në mënyrë demokratike në Shqipëri, do të jetë kontribut jo vetëm për vendin, por edhe për mbarë rajonin.

Pyetur nga KosovaLive, se cili do të ishte kontributi i OSBE-së gjatë vitit 2005 në Shqipëri dhe ku do të konsistojë veçanërisht bashkëpunimi me Qeverinë Shqiptare, Vacek, deklaroi: “Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të vazhdojë të përmbushë mandatin e saj të përditësuar në vitin 2003 - që nga ndihmesa për reformën e pronave dhe atë gjyqësore deri tek mbështetja për policinë”. “Përparësia numër një, si përsa u përket burimeve tona njerëzore ashtu edhe financiare, është mbështetja për reformën zgjedhore dhe për përgatitjen e zhvillimin e zgjedhjeve të vitit 2005”.

Po ashtu Vacek, dha opinion për Agjencinë edhe rreth klimës politike që ekziston në Tiranë. “Mua më duket se përfaqësimi politik po merret seriozisht me finalizimin e legjislacionit zgjedhor dhe përgatitjeve për zgjedhjet. Megjithatë, do të ishte mirë që këto debate të prodhonin një rezultat konsensual, gjë që është shumë e rëndësishme për një marrëveshje për rindarjen e zonave zgjedhore sa më shpejt që të jetë e mundur. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka kontribuar në këtë proces duke dhënë ndihmesë në zhvillimin e legjislacionit dhe duke siguruar mbështetje teknike për përgatitjet zgjedhore”, u shpreh ai.

Pyetur se çfarë orienton OSBE për udhëheqjen politike të Tiranës, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike në pranverë të vitit 2005, Vacek orienton “vetëm vullnet të mirë politik”. “Unë do t’i sugjeroja asaj që të demonstronte vullnet të mirë politik për zgjidhjen e çështjeve ligjore dhe sistimore që kanë mbetur pa u zgjidhur, të mos i politizonte përgatitjet teknike, të mobilizonte burimet, si financiare ashtu edhe teknike, për përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve”.

Por, ambasadori i OSBE-së nuk jep komente të zgjeruara rreth punës që ka bërë Qeveria Shqiptare në lidhje me negociatat me Bashkimin Evropian. “Ne nuk komentojmë mbi çështje që u përkasin institucioneve të tjera, kjo del jashtë mandatit tonë”. “Megjithatë, ne e dimë se standardet e OSBE-së, sidomos në Dimensionin Njerëzor, përfaqësojnë një

referencë të qartë për Bashkimin Evropian në zhvillimin e procesit të stabilizim-asociimit”, vijoi ai.

Po ashtu, Vacek i përgjigjet shkurt pyetjes së KosovaLive, nëse mendon se janë përmbushur detyrat që Brukseli i ka vënë Tiranës zyrtare, si dhe nëse janë bërë përpertime. “Kjo nuk ka lidhje me Prezencën e OSBE-së”, thotë ai.

Pyetur se çfarë do të ndodhte për Shqipërinë në rast se zgjedhjet parlamentare nuk do të zhvilloheshin sipas parametrave, Vacek shprehet se “kjo do të ishte vetëm një hap pas për demokracinë”. “Prezenca e OSBE-së në Shqipëri bën më të mirën e mundshme për ta ndihmuar Shqipërinë në përgatitjen e zgjedhjeve, në mënyrë që ajo t’i plotësojë standardet sa më mirë që të jetë e mundur. Mosarritja e tyre do të përbënte një hap të madh mbrapa për demokracinë shqiptare”.

Vacek i sheh të lidhura ngushtë mbarëvajtjen e zgjedhjeve parlamentare që zhvillohen në Shqipëri me rajonin. “Zhvillimi i suksesshëm i zgjedhjeve demokratike përbën një kontribut për stabilitetin dhe bashkëpunimin në rajon”, thotë në fund ai.